



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM
Nr. 19, datë 26.11.2021

**PËR LEJIMIN E KANDIDIMIT TË ZOTIT ALBERT DEMIRNELI NË VENDIN
VAKANT PËR GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA
GJYKATA E LARTË NË DATAT 22.11.2018, 19.04.2019 DHE 03.06.2021**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Ervin Pupe	- Kryetar
Marsida Xhaferllari	- Zëvendëskryetare
Elsa Toska	- Anëtare
Adnan Xholi	- Anëtar
Astrit Kalaja	- Anëtar
Elona Toro	- Anëtare
Gjon Fusha	- Anëtar
Kleanthi Zeka	- Anëtar
Rilinda Selimi	- Anëtare/relatore

Asistuar nga sekretare **Ermelinda Kadiu**, me praninë e **Avokates së Popullit, zonjës Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), të përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të fuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve: **zotit Bledar Dervishaj**, përfaqësuesit i autorizuar i Presidentit të Republikës, dhe **zonjës Mimoza Arbi**, përfaqësuese e autorizuar e **Kryetarit të Kuvendit**, në mbledhjen e datës 26.11.2021, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATIT: Albert Demirneli

OBJEKTI: Kandidim për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese në vendin vakant të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 22.11.2018, 19.04.2019 dhe 03.06.2021.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së KED, zonjës Rilinda Selimi, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, zonja Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Fakte në lidhje me procedurën e kryer nga KED

1. Gjykata e Lartë, në datën 22.11.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të përfundimit të mandatit, si pasojë e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit Fatmir Hoxha. Hapja e procedurës është shpallur në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/ç të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 8577/2000).

2. Në përfundim të afatit të kësaj procedure, Gjykata e Lartë i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (në vijim KED), listën e kandidatëve, të shoqëruar me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

3. KED, me vendimin nr. 6, datë 05.04.2019, ndër të tjera, vendosi pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave për këtë vakancë të shpallur, si dhe njoftimin e Gjykatës së Lartë për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave.

4. Në datën 03.06.2021, Gjykata e Lartë, me të njëjtën bazë ligjore, ka rishpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e këtij vendi vakant. Pas përfundimit të afatit, Gjykata e Lartë i ka dërguar KED-së, një listë të dytë të kandidatëve, që i ishin përgjigjur rithirrjes së saj, të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej kandidatëve për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore. Ndërmjet kandidatëve që ka shprehur interesin pas rishpalljes së procedurës për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe z. Albert Demirneli.

5. Në vijim, KED-ja në mbledhjen e datës 12.07.2021 vendosi shfuqizimin e vendimit të saj nr. 6, datë 05.04.2019 “Për pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Gjykatën e Lartë për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave”, si dhe rifillimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, duke përfshirë në një listë të përbashkët, të gjithë kandidatët që i ishin përgjigjur të gjitha shpalljeve.

6. Në të njëjtën mbledhje të datës 12.07.2021, KED realizoi edhe procedurën e shortit manual për përzgjedhjen e anëtarit relator dhe të këshilltarit ligjor për këtë vakancë, në zbatim të nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 115/2016), pikës 4 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar (në vijim vendimi nr. 4/2019 i KED) dhe pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të Vendimit të KED-së nr. 2, datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, i ndryshuar. Me anë të kësaj procedure, relatore për këtë vakancë u përzgjedh anëtarja Rilinda Selimi, ndërsa këshilltar ligjor Laureta Nezaj.

7. Në datën 14.07.2021 kandidati Albert Demirneli u njoftua me shkrim, në rrugë elektronike, për t'u paraqitur brenda tre ditëve në zyrën e posaçme të KED-së për tërheqjen e formularëve standard dhe të udhëzimeve të nevojshme për vijimin e procedurës së verifikimit të kandidimit të tij. Ky njoftim u krye në zbatim të pikës 22 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së.

në adresën e postës elektronike të deklaruar nga vetë kandidati Albert Demireli dhe kopje e email-it është administruar në dosjen e kandidimit.

8. Në të njëjtën datë 14.07.2021, me e-mail drejtuar KED-së, kandidati Albert Demireli ka konfirmuar marrjen dijeni të njoftimit për fillimin e procedurave të verifikimit dhe në datë 19.07.2021 ai u paraqit pranë KED-së, tërhoqi për plotësim formularët standard të deklarimit dhe autorizimet e duhura për procedurën e aplikimit për plotësimin e vendit vakant, objekt i kësaj procedure verifikimi.

9. KED, në zbatim të neneve 228, 229, 235, 236 dhe 237 të Ligjit nr. 115/2016 si dhe Vendimit nr. 4/2019 të KED, ka kryer veprimet verifikuese standarte si dhe hetim të thelluar nëse kandidati Albert Demireli plotëson kushtet dhe kriteret e kandidimit, që përcaktohen në pikat 4 dhe 5 të Nenit 125 të Kushtetutës dhe neni 7/a i Ligjit nr. 8577/2000.

10. KED me vendimin nr. 11, datë 20.10.2021 vendosi "*Miratimin e formularit të vetëdeklarimit nga kandidati për anëtar i Gjykatës Kushtetuese për pozicione drejtuese të mbajtura në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*", me efekt dhe fuqi juridike deri më datë 31.12.2021. Ky vendim hyri në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare nr. 164, datë 22.10.2021. Në vijim, në datë 25.10.2021 është njoftuar me e-mail kandidati Albert Demireli të paraqes këtë formular të plotësuar, jo më vonë se 3 ditë nga marrja e këtij njoftimi. Në datë 26.10.2021 kandidati Albert Demireli ka dorëzuar të plotësuar formularin e vetëdeklarimit.

11. KED administroi Raportin Përfundimtar në lidhje me verifikimin e kandidatëve që kanë aplikuar për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 138/2015 "*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*", i ndryshuar (në vijim ligji nr. 138/2015) të përgatitur nga struktura përgjegjëse e KED për Dekriminalizimin. Ky raport u përfshi në dosjen e kandidimit të kandidatit Albert Demireli.

12. Gjatë procedurës së verifikimit dhe sipas komunikimit të Këshillit në rrugë elektronike më datë 09.11.2021, kandidati Albert Demireli ka depozituar në datë 12.11.2021 shpjegimet përkatëse dhe dokumentacion bashkëngjitur, protokolluar me nr. 251 prot, për çështje të lidhura me verifikimin e kandidaturës së tij.

13. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të verifikimit, në zbatim të neneve 228, 229, 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016 si dhe pikës 29 të Vendimit nr. 4/2019 të KED, anëtarja relatore e KED ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

14. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit nr. 4/2019 të KED, Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datë 26.11.2021, rendin e ditës si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit aktet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe shqyrtimi i relacionit "*Mbi procedurën e verifikimit të kandidaturës së zotit Albert Demireli në vendin vakant për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 22.11.2018, datë 19.04.2019 dhe rishpallur në datë 03.06.2021*".

15. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit nr. 4/2019, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatit Albert Demireli.

16. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatorja mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materialet të çështjes, iu dërgua edhe Avokatit të Popullit.

17. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, rendi i ditës dhe relacioni i përgatitur për kandidatin Albert Demireli u është njoftuar edhe subjekteve, të cilët sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjen e KED-së.

18. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së KED-së, si dhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

19. Në mbledhjen e datës 26.11.2021, pas relatimit të çështjes nga anëtarja relatore dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e tjerë, KED dëgjoi qëndrimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatis Albert Demireli si dhe dëgjoi mendimet e përfaqësuesve të autorizuar të Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Kuvendit, si subjekte të ftuara nga KED.

20. Avokati i Popullit zonja Erinda Ballanca nuk parashtroi vërejtje në lidhje me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatis Albert Demireli. Avokati i Popullit lidhur me këtë rast kandidimi u shpreh se: *“Pyetja që unë kisha dhe që e kam në materialin e përmbledhur që e kam paraqitur pranë jush, ka të bëjë me plotësimin e kriterit të mesatares, kjo edhe për shkak se KED-të të ndryshme nuk kanë pasur asnjëherë unanimitet në lidhje me këtë çështje. Në vitin 2019 ai është konsideruar si kriter përjashtues. Në vitin 2020 ka pasur pakicë por është konsideruar në shumicë si një kriter përjashtues, pra, jo vetëm si kriter vlerësues...Nga leximi i përgjithshëm i ligjit thuhet...që “Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të...” A i ka plotësuar apo jo, kriteret e mësipërme? Nëse nuk është plotësuar kriteri i mesatares mbi 8 konsiderohet që personi nuk mund të kualifikohet për të shkuar në Gjykatë Kushtetuese. Ka pasur goxha interpretime dhe duam që ta lexojmë sepse po të njëjtin problematikë kemi pasur edhe për rastet e anëtarve të Komisioneve të Vetëingut në lidhje me referimin e kriterit të mesatares. Është bërë një zhurmë shumë e madhe publike për integritetin e Avokatit të Popullit në atë kohë sepse edhe ne kemi bërë vlerësimin nëse Avokati i Popullit e ka vlerësuar si duhet apo jo përmbushjen e kriterëve ligjore për të vënë kandidatin në një listë apo në një listë tjetër. Kështu që unë do të kërkoja shumë që të dija nëse i është kërkuar apo i është bërë me dije kandidatis si e konsideron ai të plotësuar apo jo këtë kriter? Të paktën që të kemi si e konsiderim, se ndoshta ka bërë ndonjë master, ndoshta ka bërë ndonjë gjë tjetër. Nëse ka ndonjë titull tjetër studimesh apo ndonjë pas universitar, i cili në një mënyrë apo në një mënyrë tjetër të ketë përmirësuar, të ketë rikuperuar ecurinë e tij përsa i përket arsimit. Kjo ka ndodhur në herët e tjera në KED-të e tjera për ndonjë kandidatin tjetër, prandaj po e them. Mund të ketë pasur vlerësimin e arsimit të lartë shumë të ulët dhe mund të ketë bërë një master me vonë dhe ka pasur rezultat. Ja u them këtë çështje, se shqetësimi dhe merakun im i vetëm është se mund të përballet KED-ja për efekt të integritetit në të ardhmen me goxha problematika përsa i përket çështjes së mesatares dhe dërgimi në këto lloj instancash kaq të larta të personave me rekorde jo dhe aq të mira arsimore. Gjykata Kushtetuese është gjykatë shkencore dhe jo gjykatë fakti.”*

II. Të dhëna dhe rezultatet e procedurës së verifikimit:

21. Kandidati Albert Demireli është me shtetësi shqiptare, me numër personal të identifikimit G40728095K. Ai ka përfunduar studimet në vitet 1983-1987 në Universitetin e

Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike Juridike dhe është diplomuar “Jurist”, pajisur me Diplomë nr. 1756 B, datë 27.06.1987.

22. Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se kandidati Albert Demireli ka ushtruar veprimtaritë profesionale të mëposhtme:

- a) *31 janar 2008 e në vazhdim Prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
- b) *01 qershor 2002 – 31 janar 2008 zv/prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
- c) *07 janar 2002-31 maj 2002 zv/prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë*
- d) *31 korrik 1994 – 7 janar 2002 prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mirditë*
- e) *Korrik 1993- korrik 1994 hetues Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër*
- f) *Maj 1992 – qershor 1993 zv/kryetar i Hetuesisë Dibër*
- g) *16 tetor 1991 – maj 1992 kryetar i Hetuesisë Dibër*
- h) *7 gusht 1987- 18 tetor 1991 hetues, Hetuesia e Rrethit Kukës*

Në lidhje me vërtetimin e përvojës profesionale në dosjen e kandidimit janë administruar ndër të tjera: shkresë “Për emërim kuadri” nr. 1044, datë 06.07.1994 e Prokurorit të Përgjithshëm; shkresë “Për emërim kuadri” nr. 23, datë 10.01.2002 e Prokurorit të Përgjithshëm; Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 3214, datë 07.01.2002; shkresë “Për emërim kuadri” nr. 1039, datë 30.05.2002 e Prokurorit të Përgjithshëm si dhe bashkëlidhur Urdhër nr. 15, datë 30.05.2002.

23. Kandidati Albert Demireli, si magjistrat/prokuror në detyrë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me vendimin nr. 323, datë 10.12.2020 ka vendosur: “1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Albert Demireli, Prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë”, vendim i cili është i formës së prerë.

24. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga Neni 125 pika 5 i Kushtetutës dhe neni 7/a pika 1, shkronja “c” i ligjit nr. 8577/2000, që kandidati të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë dhjetë viteve të fundit nga data e kandidimit, verifikimi u krye për periudhën 10 vjeçare nga data e kandidimit: 02.07.2011 – 02.07.2021.

25. Lidhur me funksionet politike në administratën publike, nga jetëshkrimi i kandidatit dhe aktet e administruara në dosjen e kandidimit, nuk rezulton që kandidati Albert Demireli të ketë ushtruar funksione politike në administratën publike.

26. Sa i takon pozicioneve drejtuese në partitë politike, KED në datat 03.08.2021, 30.09.2021 dhe 07.10.2021 i është drejtuar me kërkesë për informacion partive politike, duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Kërkesave të KED iu janë përgjigjur gjithsej 8 parti politike dhe secila prej tyre konfirmon në thelb se kandidati Albert Demireli duke filluar nga viti 2011, nuk ka mbajtur funksione drejtuese apo të ketë qenë anëtare partie.

27. Duke qenë pa përgjigje nga pjesa më e madhe e partive politike, për vijueshmërinë e procesit mbi një bazë të ligjshme, KED si diskutoi gjerësisht këtë çështje, me vendimin nr. 11, datë 20.10.2021 vendosi *“Miratimin e formularit të vetëdeklarimit nga kandidati për anëtar i Gjykatës Kushtetuese për pozicione drejtuese të mbajtura në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit”*, me efekt dhe fuqi juridike deri më datë 31.12.2021. Ky vendim hyri në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare nr. 164, datë 22.10.2021. Në vijim, datë 25.10.2021 është njoftuar me e-mail kandidati Albert Demirmeli të paraqes këtë formular të plotësuar, jo më vonë se 3 ditë nga marrja e këtij njoftimi. Kandidati Albert Demirmeli në datë 26.10.2021, ka dorëzuar të plotësuar formularin e vetëdeklarimit, duke deklaruar se nuk ka pasur ndonjë pozicion drejtues në parti politike.

28. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga Neni 125 pika 5 i Kushtetutës dhe neni 7/a pika 1, shkronja “ç” të ligjit nr. 8577/2000, që kandidati: *“ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;”* KED kreu veprimet verifikuese sipas përcaktimeve të Nenit 236 të ligjit nr. 115/2015 dhe ligjit nr. 138/2015.

29. Lidhur me verifikimin e *të dhënave të dekriminalizimit*, KED, në bazë të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016 dhe të pikës 82 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, me shkresën nr. 80 prot., datë 29.07.2021, ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati Albert Demirmeli sipas ligjit nr. 138/2015. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1218/1 prot., datë 30.07.2021, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi pa veprim formularët e vetëdeklarimit, duke arsyetuar në thelb se *“sipas ligjit nr. 138/2015, vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit dhe ligjit nr. 115/2016, organi përgjegjës për administrim e Formularëve të Vetëdeklarimit të kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese, është Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, që nëpërmjet strukturës përkatëse ... kryen verifikimin paraprak të të dhënave të deklaruara në të dhe kërkon verifikimin të plotë vetëm, a) kur subjekti nuk ka deklaruar asnjë fakt për të kaluarën kriminale dhe ka indicie... b) kur personat kanë deklaruar të dhëna për gjendjen e tyre gjyqësore, por organi vlerëson se duhet përcjell për të verifikuar saktësinë e të dhënave të pasqyruara...”*

30. Në kushtet kur ky qëndrim i Prokurorisë së Përgjithshme ishte i ndryshëm në raport me qëndrimin e mbajtur përgjatë veprimtarisë së KED-së për vitet 2019 dhe 2020, ndonëse kuadri ligjor nuk ka pësuar ndryshime, KED me shkresën nr. 209 prot., datë 01.10.2021 i ka dërguar përsëri Prokurorisë së Përgjithshme për kompetencë verifikimi (edhe) formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati Albert Demirmeli sipas ligjit nr. 138/2015. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1407/1 prot., datë 11.10.2021 ka kthyer përgjigje duke bërë me dije se: *“... Në vijim të kërkesave tuaja, nga ana jonë i është përcjellë të gjitha prokurorive në rrethe, në mënyrë që përgjigjet t’ju kthehen sa më shpejtë të jetë e mundur. Theksojmë se në Prokurorinë e Përgjithshme nuk gjendet një databazë me të dhëna lidhur me informacionet e ardhura nga agjencitë ligjzbatuese në emër të shtetasve dhe për këtë arsye është e pamundur që të verifikohet nëse disponohen informacione në emër të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese”*. Në vijim, me shkresën nr. 234 prot., datë 15.10.2021 KED i është drejtuar Prokurorit Përgjithshëm duke e vënë në dije të kërkesave drejtuar prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë dhe të apelit në kuadër të verifikimit të formularit të vetëdeklarimit të plotësuar (edhe) nga kandidati Albert Demirmeli, sipas ligjit nr. 138/2015. Nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm nuk është kthyer përgjigje.

31. Sa më lart, konstatohet se procedura e verifikimit të të dhënave të dekriminalizimit ka marrë kohë të konsiderueshme, duke tejkaluar dukshëm afatin ligjor 30 ditor dhe nuk ka përfunduar sipas nenit 236 pika 4 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”. Ndërkaq, struktura përgjegjëse e KED për dekriminalizimin, ka hartuar raportin përkatës, i cili është pjesë e dosjes së kandidatit.

32. Gjithashtu, për verifikimin e integritetit, të lidhur me *pastërtinë e figurës dhe të gjendjes gjyqësore* të kandidatit Albert Demirneli, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, KED i është drejtuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (*shkresa nr. 79 prot., datë 29.07.2021*); me kërkesë për informacion Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (*shkresa nr. 81 prot., datë 29.07.2021*); me kërkesë për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (*shkresa nr. 133 prot., datë 30.07.2021; shkresa nr. 189 prot., datë 27.09.2021*); me kërkesë për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (*shkresa nr. 134 prot., datë 30.07.2021*); me kërkesë për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (*shkresa nr. 190 prot., datë 27.09.2021*), me kërkesë për informacion Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (*shkresa nr. 242 prot., datë 21.10.2021*); me kërkesë për informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; me kërkesë për informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, pranë Gjykatës së Apeleve dhe SPAK (*shkresa nr. 221 prot., datë 11.10.2021*); me kërkesë për informacion Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër (*shkresa nr. 237 prot., datë 18.10.2021*).

33. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me shkresën nr. 2616 prot., datë 23.08.2021, është përgjigjur se: *“në përfundim të procedurave të verifikimit, nuk disponohen të dhëna/informacione që bien në kundërshtim me kërkesat e pikës 89 gërmat “a” dhe “c” për integritetin e figurës së z. Albert Demirneli.”*

34. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme ka dërguar përgjigje, me shkresën nr. 2083 prot., datë 20.10.2021, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin Albert Demirneli: *“Nuk figurojnë të evidentuar për veprimtari kriminale.”*

35. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. 8269/1 prot., datë 04.08.2021 dhe shkresën nr. 10865/1 prot., datë 14.10.2021, është përgjigjur se: *“rezulton i padënuar nga gjykata penale Shqiptare”.*

36. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr. 4460/1 prot., datë 16.08.2021, është përgjigjur se: *“Nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.”*

37. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka dërguar përgjigje me shkresën nr. 15819/3 prot., datë 28.10.2021, sipas të cilës rezulton se:

“Albert Isuf Demirneli, lindur më 28.07.1964, nuk figuron i ndaluar/arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit.

- Nuk ka gjeneralitete të tjera të regjistruara, përveç atyre të përmendura më sipër.

- Nuk rezulton të jetë dëbuar nga territori i ndonjë shteti tjetër.

- Pas verifikimit të kryer në arkivin elektronik ZQK Interpol Tirana dhe sistemin ASF-2, të Interpolit, ka rezultuar se për këtë shtetas nuk ka të dhëna.

38. Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë në përgjigjen e saj nr. 8045/1 prot, datë 14.10.2021 ka informuar KED, si vijon:

"Në përgjigje të shkresës suaj, Nr. 221 Prot. datë 11.10.2021, ju konfirmojmë se pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar rezulton që :

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ka regjistruar procedimin penal me Nr. 160, viti 2019, mbi bazën e kallëzimit të shtetasës Leonora Xhaxhe, pa asnjë emër të regjistruar. Kjo shtetase, në kallëzimin e saj ka pretenduar për përfshirje në veprime korruptive të disa shtetasve, prokurorëve dhe gjyqtarëve, ndërmjet të cilëve edhe prokurorin Albert Demirneli, në lidhje me vendimin e mosfillimit të procedimit penal të dhënë nga ana e tij më datë 16.11.2006.

Nga hetimet e kryera në lidhje me këtë procedim, nuk rezulton që të ketë elemente të veprës penale të "korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë", të parashikuar nga neni 319/ç, i K.Penal.

Pas kryerjes së hetimeve është vendosur shpallja e moskompetencës dhe kalimi i akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 31.03.2021.

Për më shumë informacion, ju mund t'i drejtoheni Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Bashkëlidhur, po ju dërgojmë edhe një kopje të njësuar me origjinalin të shkresës përcjellëse.

Ndaj shtetasit Albert Demirneli rezulton të ketë ardhur materiali kallëzues, me kallëzues shtetasin Altin Hoxha, i cili është vendosur të dërgohet për vlerësim me shkresën Nr. 555/1 Prot., datë 29.10.2020, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë edhe një kopje të njësuar me origjinalin të shkresës përcjellëse.

Pas verifikimeve të kryera në regjistrin e njoftimit të veprave penale të Prokurorisë së Krimeve të Rënda Tiranë, nuk rezulton që në emër të shtetasit Albert Demirneli, të jetë regjistruar ndonjë procedim penal."

39. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me shkresën nr. 1596/1 prot., datë 25.10.2021 i ka kthyer përgjigje KED si vijon:

"Në lidhje me kandidatin Albert Isuf Demirneli, i datëlindjes 28.07.1964, me nr. ID G40728095K, pas verifikimit të kryer në Zyrën e Regjistrimit rezulton të jenë regjistruar:

-materiali hetimor nr. 1044/2019 për cilin është marrë vendimi i mosfillimit me datë 18.04.2019;

-materiali hetimor nr. 2598/2020 për cilin është marrë vendimi i mosfillimit me datë 04.08.2020.

Bashkëlidhur po ju vëmë në dispozicion kopje të njësuar me origjinalin të materialeve me nr. 1044/2019 dhe nr. 2598/2020".

40. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. 3569 prot, datë 01.11.2021, është përgjigjur se:

"... në kuadër të verifikimeve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, referuar kandidatëve për pozicionet vakante për anëtar në Gjykatën e Lartë, lidhur me z. Albert Demirneli (për sa i

përket kallëzimeve në ngarkim të subjektit Albert Demirneli nga shtetasit Metush Rama, Altin Hoxha) sqarojmë si më poshtë:

Ju bëjmë me dije se verifikimet janë kryer nëpërmjet sistemit CCMIS (Sistemi informatik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore) i cili krijon mundësi kërkitimi për të gjitha çështjet gjyqësore të regjistruara pranë kësaj gjykate nga periudha 2007 e në vijim. Ky sistem ofron mundësi kërkitimi për të gjitha çështjet gjyqësore civile apo penale të regjistruara pranë kësaj gjykate kryesisht nëpërmjet emrit të palëve ndërgjyqëse. Gjithashtu për periudhën e papasqyruar në këtë sistem verifikimet kryhen manualisht nga Zyra e Arkivës të kësaj Gjykate.

Sa më sipër, nga verifikimet e kryera nga Zyra e Arkivës dhe në sistemin CCMIS, bashkëlidhur kësaj shkrese gjeni:

- 1. Kopje të vendimit nr.(11 -2019-3240) 344, datë 11.06.2019-me kërkesës Metush Rama;*
- 2. Kopje të vendimit nr.(11-2020-3571) 541, datë 28.12.2020, me ankesës Altin Hoxha.”*

41. Duke veçuar përgjigjet e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës sipas pikave 31 dhe 32 më sipër, Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, pranë Gjykatës së Apeleve, kanë kthyer përgjigje dhe ka rezultuar se ndaj kandidatit Albert Demirneli, nuk ka kallëzime/procedime penale. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër me shkresën nr. 7825/1 prot., datë 22.10.2021, është përgjigjur se: *“nga verifikimet e bëra në regjistrat elektronik të kallëzimeve dhe procedimeve penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, rezulton se nuk janë regjistruar dhe nuk ka hetim, kallëzime penale, procedime penale apo çështje të dërguara në gjykatë”.*

42. Këshilli, në datë 09.11.2021, në zbatim të pikës 23, 25, 26 dhe 93 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, përmes e-mail i ka komunikuar kandidatit Albert Demirneli përgjigjet e dhëna sipas pikave 38, 39 dhe 40 më sipër nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë, Prokuroria si dhe Gjykata pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, duke e ftuar të paraqesë shpjegime me shkrim dhe dokumente shtesë që i vlerëson.

43. Kandidati Albert Demirneli, në datë 12.11.2021 ka depozituar pranë KED materialin me nr. 251 prot, në të cilin parashtron këto shpjegime:

“Në cilësinë e Prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë i jam nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar (veting) të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ku me Vendimin Nr. 323, datë 10.12.2020, marrë formë të prerë më datën 10.02.2021, jam konfirmuar në detyrën e prokurorit nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Fillimisht sqaroj se, në lidhje me kallëzimet që janë në përmbajtje të e-mailit të dërguar nga ana juaj, nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është kryer një proces i thelluar hetimi administrativ në lidhje me këto kallëzime. Në përfundim të këtij hetimi, ka rezultuar se pretendimet e kallëzuesve kanë qenë të pabazuara në ligj dhe në prova, e për rrjedhojë vendimmarrja ime ka qenë e bazuar në ligj. Ky rezultat i hetimit administrativ gjendet i pasqyruar edhe në vendimin e konfirmimit tim në detyrë nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendim ky që i është bashkangjitur kërkesës sime për të kandiduar si Anëtar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

1. Pavarësisht sa më sipër, dëshiroj t'ju informoj se mbi bazën e kallëzimit të ardhur nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë më datë 08.03.2018, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal Nr. 2038 në ngarkim të të pandehurit Metush Rama, i akuzuar për kryerjen e veprës penale "Plagosja e lehtë me dashje", parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal. Në përfundim të hetimit paraprak, kjo çështje në datën 12.03.2018 është dërguar për gjykim. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin Nr. 2100, Regj. Themeltar datë 18.12.2018, ka vendosur: Deklarimin fajtor të pandehurit Metush Ramiz Rama, për kryerjen e veprës penale "Plagosja e lehtë me dashje" dhe në bazë të nenit 89 të Kodit Penal dënimin e tij me 6 muaj burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal gjykata ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim duke vënë në provë të pandehurin Metush Ramiz Rama për një periudhë kohe prej 12 muajsh, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryej veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës.

Kallëzuesi ka pretenduar se vendimi i dënimit me kusht sipas nenit 59 të K.Penal dhënë nga gjykata nuk duhej vënë në ekzekutim pa marrë formë të prerë.

Në lidhje me këtë pretendim të kallëzuesit sqarohet se, një ndër funksionet e prokurorit është edhe marrja e masave dhe nxjerrja e akteve procedurale penale në funksion të zbatimit të vendimit penal të dhënë nga gjykata. Kështu, në nenin 24, të K.Pr. Penale, i cili nën emërtimin "Funksionet e prokurorit" përcakton se: "Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod".

Në nenin 463, "Veprimet e prokurorit", thuhet shprehimisht se: "Prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, merr masa për ekzekutimin e vendimit".

Në urdhrin e Ekzekutimit si më sipër, përveç neneve 462-467 të K.Pr. Penale, është përmendur edhe neni 59 i K.Penal. Në vështrim të pikës 4 të këtij neni, të ndryshuar me ligjin nr. 36, datë 30.03.2017, thuhet shprehimisht se: "Afati i provës fillon nga e nesërmja e shpalljes së vendimit të Gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim".

Në këto kushte, nxjerrja e urdhrin të ekzekutimit është tërësisht i bazuar në ligjin procedural dhe material penal.

2. Ndërsa pretendimi i kallëzuesit në lidhje me referimin në ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale" të ndryshuar me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2008, është i gabuar, pasi shkurtimi i vendimit është bërë i ekzekutueshëm vetëm me ligjin nr. 80/2018 datë 15.11.2018 (hyrë në fuqi në datë 21.12.2018), ndërkohë që urdhri i ekzekutimit të vendimit të prokurorit Albert Demirneli i përket të datës 18.12.2018, pra përpara hyrjes në fuqi të ligjit, nuk qëndron pasi:

Së pari: Në urdhrin e ekzekutimit objekt analize, ndër të tjera i jam referuar Ligjit nr. 8331, datë 21.04.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale" i ndryshuar me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2008, si një ligj i posaçëm i cili rregullon fazën procedurale të ekzekutimit të vendimeve penale nëpërmjet urdhrin të ekzekutimit që nxjerr prokurori.

Së dyti: Pretendimi se vendimi i është bërë i ekzekutueshëm vetëm me ligjin nr. 80/2018 datë 15.11.2018, nuk qëndron pasi ligji nr. 80/2018 datë 15.11.2018, është botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 172, datë 05.12.2018, e për rrjedhojë ky ligj ka hyrë në fuqi 15

ditë pas botimit në fletoren zyrtare, pra më datë 21.12.2018, sikundër e ka pranuar vetë ankuesi, ndërkohë që Urdhri i Ekzekutimit mban datën 18.12.2018, kështu që nuk mund ti referohesh një ligji që ende nuk kishte hyrë në fuqi. Bashkëlidhur do të gjeni vendimin e mosfillimit të procedimit penal marrë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Në lidhje me pretendimin e kallëzuesit Altin Hoxha, se nuk janë marrë parasysh fakte dhe prova konkrete dhe nuk është ngarkuar me përgjegjësi penale bashkëautori Klejdi Yzeiraj, sqarojmë se ky pretendim nuk qëndron dhe është tërësisht i pavërtetë. Organi procedues ka kryer hetime të plota dhe objektive në kuadër të procedimit penal nr. 6099 regjistruar më datë 01.08.2018, duke marrë parasysh të gjitha faktet, provat dhe rrethanat e çështjes. Në përfundim të hetimeve, në cilësinë e prokurorit të çështjes më datë 22.01.2019 kam vendosur "Dërgimin e çështjes për gjykim" në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të procedimit penal nr. 6099 në ngarkim të pandehurve, Herold Bushi dhe Klejdi Yzeiraj, të akuzuar për kryerjen e veprës penale "Plagosja e lehtë me dashje" në bashkëpunim, parashikuar nga neni 89-25 të Kodit Penal në dëm të viktimës së veprës penale Altin Hoxha.

Kallëzuesi Altin Hoxha ka pretenduar se ka marrë në dorëzim aktin e njoftimit të përfundimit të hetimeve, pa datë dhe të pa nënshkruar nga ana ime. Ju bëj me dije se ky pretendim është tërësisht i pavërtetë. Në fashikullin e procedimit penal nr. 6099/2018 në faqen 178 që i përket njoftimit për përfundimin e hetimeve të viktimës, së veprës penale rezulton se ky akt është marrë nga ana ime më datë 17.01.2019, dhe po në këtë datë ky akt i është njoftuar viktimës së veprës penale (Altin Hoxha) nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, Drilon Koldashi, kundrejt nënshkrimit. Po kështu, akti i përfundimit të hetimeve është i nënshkruar nga ana ime rregullisht sipas kërkesave të ligjit.

Gjithashtu, sqaroj se në aktet e fashikullit të procedimit penal nr. 6099/2018 në ngarkim të pandehurve Herold Bushi dhe Klejdi Yzeiraj, nuk rezulton asnjë procesverbal për marrjen e të dhënave nga persona që kanë dijeni për rrethana të hetimit pa firmë të oficerit të policisë gjyqësore dhe pa nënshkrim të deklaruesit, akte procedurale të cilat i janë vënë në dispozicion Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, e cila në përfundim të shqyrtimit të akteve dhe të përmbajtjes së kallëzimit të shtetasit Altin Hoxha ka vendosur: Mosfillimin e procedimit penal. Bashkëlidhur do të gjeni vendimin e mosfillimit të kallëzimit penal Nr. 2598, datë 04.08.2020 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës.

3. Shtetasi Altin Hoxha, për të njëjtin fakt i është drejtuar me kallëzim penal edhe Prokurorisë së Posaçme kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, e cila pasi ka shqyrtuar materialin kallëzues ka vendosur shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, pasi janë kryer verifikimet e nevojshme në lidhje me pretendimet e kallëzuesit Altin Hoxha, me datë 05.11.2020 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal në lidhje me kallëzim penal nr. 4116, datë 30.10.2020. Bashkangjitur gjeni kopje të vendimit të mosfillimit të procedimit penal.

4. Nga ana e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, me shkresën nr. 7701/1 prot./K.B., datë 23.11.2020, të Drejtuesit të Prokurorisë, Z. Arben Kraja, më është kthyer përgjigje mbi kërkesën time se: Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Tiranë, ka regjistruar Procedimin Penal

Nr. 27, i vitit 2019, mbi bazën e akteve të procedimit penal nr. 159, datë 15.07.2019, të dërguara për kompetencë nga ish-Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë.

Nga aktet rezultojnë se çështja penale për këtë rast është regjistruar në bazë të kallëzimit penal nr. 26, viti 2019, të shtetases Leonora Xhaxhe, të regjistruar në ish-Prokurorinë për Krime të Rënda, si dhe mbi bazën e Vendimit nr. 183, datë 24.06.2019 të ish-Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Për këtë vendim gjyqësor është vendosur shfuqizimi i vendimit për mosfillimin e procedimit penal për kallëzim penal nr. 26, të vitit 2019, si një vendim i marrë jashtë afatit parashikuar në ligj.

Duke iu referuar akteve procedurale, kallëzuesja Leonora Xhaxhe, midis pretendimeve të ngritura prej saj, për një mosmarrëveshje pronësie, me persona të tjerë, dhe pretendimeve për vendime të padrejta të organeve gjyqësore në dëm të saj, ka përmendur edhe faktin se në vitin 2006, nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë është marrë një vendim i mosfillimit të procedimit penal, nënshkruar nga ana ime, nën cilësinë e Zëvendës drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Tiranë në atë kohë, vendim që sipas saj është i padrejtë.

Në këtë shkresë citohet shprehimisht se: "Objekti i hetimit të procedimit penal nr. 27, të vitit 2019, të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar Tiranë, nuk janë veprimet e kryera nga ana juaj dhe se ndaj personit tuaj nuk është filluar ndonjë hetim për sa pretendohet nga kallëzuesja, Leonora Xhaxhe. Procedimi penal nr. 26, i vitit 2019, ndodhet ende në fazën e hetimeve paraprake (Bashkëlidhur gjeni shkresën nr. 7701/1, prot./K.B, datë 23.11.2020, të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, Z. Arben Kraja).

Në përfundim të hetimeve, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar, 31.03.2021 ka shpallur moskompetencën dhe i ka kaluar aktet për kompetencë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 13.04.2021, ka regjistruar procedimin penal nr. 2574, për veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve" parashikuar si krim nga neni 186/1 i Kodit Penal dhe pasi ka kryer hetimet e nevojshme, në datën 13.09.2021 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. 2574.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1741 Akti, datë 05.11.2021 ka vendosur: "pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pushimin e çështjes penale nr. 2574/2021, për veprën penale të "Falsifikimit të dokumenteve", parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, pasi vepra penale është parashkruar.

Bashkangjitur gjeni: Kërkesën e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pushimin e çështjes si dhe Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pranimin e kërkesës dhe pushimin e çështjes".

44. Për verifikimin e të shkuarës personale referuar nenit 229 të Ligjit nr. 115/2016, KED me shkresën nr. 78 prot., datë 29.07.2021 i dërgoi për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit formularin përkatës të plotësuar sipas ligjit (edhe) nga kandidati Albert Demireli. Neni 29 i ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" përcakton se Autoriteti, në kuadër të vlerësimit, sipas legjislacionit përkatës, të cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t'u emëruar ose ngritur në detyra, ndër të tjera, për anëtar të Gjykatës Kushtetuese, i kthen përgjigje institucionit verifikues nëse, për periudhën para datës 02.07.1991, kandidati: a) ka qenë ose jo person në ndjekje për

spionazh apo terrorizëm; b) ka qenë ose jo anëtar, bashkëpunëtor, i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit, sipas përcaktimeve të këtij ligji; c) figuron ose jo në dokumente të ish -Sigurimit të Shtetit. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 1143/10 prot., datë 22.09.2021, ka dërguar vendimin nr. 396, datë 09.09.2021 pranë KED me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Albert Demirneli, duke ardhur përfundimet se: "për zotin Albert Demirneli, nga verifikimet e kryera deri tani nuk figurojnë të ketë materiale në dokumentet të ish- Sigurimit të Shtetit në emër të tyre, sipas nenit 29, pika 2 të ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

45. Për verifikimin e kushtit të kandidimit të përcaktuar nga neni 7/a pika 1 shkronja "d" i ligjit nr. 8577/2000 që kandidati "të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi." KED vlerësoi t'i drejtohet me kërkesë për informacion institucioneve, mbështetur në të dhënat në dosjen e kandidimit lidhur me funksionin publik dhe veprimtarinë profesionale të kandidatit si Këshilli i Lartë i Prokurorisë (shkresa nr. 218 prot., datë 11.10.2021), Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (shkresa nr. 239 prot., datë 21.10.2021). Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (shkresa nr. 2251/1 prot., datë 18.10.2021 dhe nr. 1992/1 prot., datë 06.08.2021), Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (shkresa nr. 3940/1 prot., datë 27.10.2021). Në përmbajtje të përgjigjeve, këto institucione konfirmojnë se periodha e punësimit e deklaruar nga kandidati është e saktë, ka deklaruar pozicionet e punës konkrete, si dhe kandidati nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi. Këshilli i Lartë i Prokurorisë bën me dije se ndaj kandidatit Albert Demirneli, është dhënë një masë disiplinore "Vërejtje", me urdhërin nr. 213, datë 19.12.2006 të Prokurorit të Përgjithshëm, masë e cila është shuar. Bashkëngjitur Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka dërguar vlerësimet e punës të kandidatit Albert Demirneli për vitet 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016 si dhe të dhëna lidhur me ngarkesën e punës. Inspektorati i Lartë i Drejtësisë konfirmon se për kandidatin Albert Demirneli, "nuk është nisur hetim disiplinor dhe nuk është paraqitur kërkesë për procedim disiplinor."

46. Neni 125 pika 5 i Kushtetutës parashikon se kriteret e tjera për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj. Neni 7/a pika 1 shkronja "dh" e ligjit nr. 8577/2000 parashikon si kusht kandidimi kalimin me sukses nga kandidati të procesit të kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

47. Për llogaritjen dhe ndjekjen e zbatimit të afatit të parashikuar në pikën 2 të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, me shkresën nr. 77 prot., datë 29.07.2021, KED i ka dërguar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe të Konfliktit të Interesit (në vijim ILDKPKI) listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë. Kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, iu bashkëlidh edhe deklarata e nënshkruar nga kandidati Albert Demirneli, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

48. ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, me shkresën nr. 3211/1 prot., dhe nr. 3211/2 prot., datë 03.09.2021, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Aktin Përfundimtar nr. 557/23, datë

03.09.2021 dhe rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Albert Demirmeli, ku në përfundim të analizës së hollësishme financiare konkludon se:

- a) *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;*
- c) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- ç) *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- d) *Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

49. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 të vendimit nr. 4/2019 të KED-së, janë kryer nga KED veprime të tjera verifikuese të kërimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit Albert Demirmeli dhe personave të lidhur me të. Konkretisht, KED, në datat 29.07.2021, 30.07.2021, 27.09.2021, 30.09.2021 dhe 14.10.2021, i është drejtuar me kërkesa për informacion dhe ka marrë përgjigjet përkatëse me të dhënat e kërkuara nga secili prej institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit), si vijon:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Parë e Investimeve, (6) Banka Intesa Sanpaolo, (7) Banka Kombëtare Tregtare, (8) Banka Procredit, (9) Banka Raiffeisen, (10) Banka Societe Generale, (11) Banka Tirana dhe (12) Banka Union.
- b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë: (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k, (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Tirana Factoring & Lease, (15) Tranzit sha, (16) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekte financiare të licencuar nga AMF: (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit WVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal, (9) ABI INVEST, (10) ALBSIG INVEST, (11) Final sh.p.k.
- ç) Institucione të tjera publike si: (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

50. Në përgjigje të kërkesave për informacion, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të listuara më sipër, me përjashtim të shoqërisë Final sha dhe Final sh.p.k, kanë dërguar përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidatin Albert Demirmeli. Moskthimi i përgjigjeve nga ana e shoqërisë Final sh.a. dhe Final sh.p.k, nuk pengon vijimin e procesit, për sa kohë nga ana e ILDKPKI është ezauruar në mënyrë shteruese verifikimi i pasurisë së kandidatit Albert Demirmeli dhe ka rezultuar pa probleme. Nga përgjigjet e administruara rezulton se nuk ka informacione shtesë për pasuritë dhe interesat private dhe ato përputhen me ato të ILDKPKI-së.

III. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi:

51. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin e kandidatit Albert Demirmeli për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 22.11.2018, 19.04.2019 dhe rishpallur në datë 03.06.2021.

52. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”

53. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;

ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”.

54. Duke iu referuar rezultateve të verifikimit të përshkruara në pjesën II të këtij vendimi, të administruara në dosjen e kandidimit si dhe dokumentacionit dhe shpjegimeve të paraqitura nga kandidati Albert Demirmeli, KED vlerëson:

i. Verifikimi shtetësisë dhe i zotësisë së plotë për të vepruar

55. Neni 7/a, pika 1, shkronja “a” i ligjit nr. 8577/2000 parashikon si kusht kandidimi shtetësinë shqiptare dhe zotësinë e plotë për të vepruar. Kandidati Albert Demirmeli është me shtetësi shqiptare dhe përgjatë procedurës së verifikimit nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që këtij kandidati t’i jetë hequr apo t’i jetë kufizuar zotësia për të vepruar.

ii. Verifikimi i arsimit

56. Neni 125 pika 4 e Kushtetutës dhe neni 7/a pika 1 shkronja “b” e ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë si kusht kandidimi “*arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë*”. Kandidati Albert Demirneli ka kryer studimet në vitet 1983-1987 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike Juridike. Ai është diplomuar “Jurist”, pajisur me Diplomë nr. 1756 B, datë 27.06.1987. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*” ky lloj arsimimi kualifikohet arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

iii. Përvoja profesionale

57. Neni 125 pika 4 i Kushtetutës dhe neni 7/a pika 2 e ligjit nr. 8577/2000 parashikojnë si kriter kandidimi përvojën e punës prej të paktën prej 15 vjet në detyrën e gjyqtarit, prokurorit, avokatit, profesorit ose lektorit të së drejtës, nëpunësit/juristit të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës, si dhe të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

58. Kandidati Albert Demirneli ka ushtruar veprimtaritë profesionale të mëposhtme:

- a) *31 janar 2008 e në vazhdim Prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
- b) *01 qershor 2002 – 31 janar 2008 zv/prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
- c) *07 janar 2002-31 maj 2002 zv/prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë*
- d) *31 korrik 1994 – 7 janar 2002 prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mirditë*
- e) *Korrik 1993- korrik 1994 hetues Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër*
- f) *Maj 1992 – qershor 1993 zv/kryetar i Hetuesisë Dibër*
- g) *16 tetor 1991 – maj 1992 kryetar i Hetuesisë Dibër*
- h) *7 gusht 1987- 18 tetor 1991 hetues, Hetuesia e Rrethit Kukës*

59. Këshilli vëren se kandidati Albert Demirneli ka një përvojë të gjatë pune në detyrën e prokurorit, të pandërprerë nga viti 1994. Ushtrimi i detyrës së prokurorit, së paku për 15 vjet, është veprimtari profesionale e parashikuar e tillë shprehimisht nga Neni 125 pika 4 i Kushtetutës dhe neni 7/a pika 2, germa “a” e ligjit nr. 8577/2000 si kusht për lejimin e kandidimit.

60. Kandidati Albert Demirneli, si magjistrat/prokuror në detyrë, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit kalimtar sipas ligjit 84/2016, “*Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “*Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, me vendimin nr. 323, datë 10.12.2020 ka vendosur: “*1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Albert Demirneli, Prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë*”, vendim i cili është i formës së prerë. Sipas Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, vendimet për konfirmimin në detyrë të subjekteve të rivlerësimit jepen për të tre komponentët e kontrollit: vlerësimin pasuror, vlerësimin e figurës dhe vlerësimin profesional.

61. Këshilli vëren se pika 3 e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 liston disa tregues të dhënash që vlerësohen për të konkluduar nëse kandidati për anëtar të Gjykatës Kushtetuese plotëson kriteret e parashikuara nga pika 2 e kësaj dispozite. Këto tregues vlerësues bazohen në disa të dhëna të përcaktuara: “*a) vjetërsia në profesion; b) përvojës së veçantë të kandidatit nënjë*

fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë; c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës; ç) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike; d) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimi përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës; dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.”

62. Në interpretim të nenit 7/a, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 8577/2000 Këshilli vlerëson se fakti se kandidati Albert Demirmeli ka përfunduar arsimin e lartë juridik në vitet 1983-1987 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, me mesatare të notave nën 8 (tetë) nuk përbën një rrethanë që shpie në ndalimin e kandidimit, pasi nuk është kusht apo kriter ndalues. Në vlerësimin e Këshillit, të dhënat lidhur me ecurinë gjatë kryerjes së arsimit të lartë, me një mesatare notash nën tetë, është një nga treguesit që vlerësohen nga KED së bashku me të dhënat e tjera të vjetërsisë në profesion, përvojës së veçantë, treguesve shkencorë si edhe me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e marra nga institucionet e tjera publike. I tillë vlerësim konstatohet nga Këshilli edhe nga përmbajtja e vendimeve të KED të vitit 2019 dhe 2020, të marra në fazën e vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit (vendimi nr. 57, datë 23.12.2020 i KED dhe vendimi nr. 152, datë 16.12.2019). Këshilli bazuar në jetëshkrimin e kandidatit, përvojën e tij të punës dhe në tërësi informacionin që përmban dosja e kandidimit arrin në përfundimin se kandidati Albert Demirmeli nuk gjendet në kushtet e ndalimit sipas dispozitave të lartcituara.

iv. Verifikimi i funksioneve politike

63. Përsa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga Neni 125, pika 5 i Kushtetutës dhe neni 7/a, pika 1, shkronja “c” i ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë dhjetë viteve të fundit nga data e kandidimit, sikurse parashtrohet edhe në pikat 24-25 më sipër, nga aktet e administruara në dosjen e kandidimit lidhur me përvojën profesionale, konstatohet se kandidati Albert Demirmeli nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike.

64. Sa i takon *pozicioneve drejtuese në partitë politike*, nga përgjigjet e dhëna nga 8 parti politike konfirmohet në thelb se *“duke filluar nga viti 2011 kandidati nuk ka mbajtur funksione drejtuese apo të ketë qenë anëtarë partie”*. Kandidati Albert Demirmeli në datë 26.10.2021, ka dorëzuar të plotësuar formularin e vetëdeklarimit *“për anëtar i Gjykatës Kushtetuese për pozicione drejtuese të mbajtura në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit”*, miratuar nga KED me vendimin nr. 11, datë 20.10.2021, duke deklaruar se nuk ka pasur ndonjë pozicion drejtues në parti politike

v. Verifikimi i integritetit

65. Neni 125 pika 5 i Kushtetutës dhe neni 7/a pika 1, shkronja “ç” të ligjit nr. 8577/2000 përcakton si kusht kandidimi që kandidati: *“ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;”* Neni 236 i ligjit nr. 115/2015 dhe ligji nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 138/2015) përcaktojnë që kandidati duhet të mos jetë i dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda ose jashtë territorit të

Republikës së Shqipërisë, të mos ketë pasur masë sigurimi personal ose urdhër dëbimi, për një listë veprash penale të parashikuara shprehimisht nga ligji.

66. Lidhur me verifikimin e të dhënave të dekriminalizimit, siç parashtrohet në pikat 29, 30 dhe 31 më sipër, procedura e verifikimit nuk ka përfunduar sipas nenit 236 pika 4 të ligjit nr. 115/2016. Struktura përgjegjëse e KED për dekriminalizimin, ka hartuar raportin përkatës, i cili është pjesë e dosjes së kandidatit. Megjithatë, Këshilli vlerëson të evidentojë se ligji nr. 138/2015, si dhe vendimi i Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138 2015 ‘Për garantimin e integriteti të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’” rregullon situatën kur rezultatet e verifikimit mbyllen pas emërimit, edhe kur nga verifikimi rezultojnë kushte ndaluese të emërimit.

67. Gjithashtu, KED për verifikimin e integritetit, të lidhur me *pastërtinë e figurës dhe të gjendjes gjyqësore* të kandidatit Albert Demirneli, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit nr. 4/2019 të KED, i është drejtuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve institucioneve të treguara pikën 32 të këtij vendimi.

68. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar me shkresën nr. 2616 prot., datë 23.08.2021, është përgjigjur se: “*në përfundim të procedurave të verifikimit, nuk disponohen të dhëna/informacione që bien në kundërshtim me kërkesat e pikës 89 gërmat “a” dhe “c” për integritetin e figurës së z. Albert Demirneli.*”

69. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme ka dërguar përgjigje, me shkresën nr. 2083 prot., datë 20.10.2021, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin Albert Demirneli: “*Nuk figurojnë të evidentuar për veprimtari kriminale.*”

70. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. 8269/1 prot., datë 04.08.2021 dhe shkresën nr. 10865/1 prot., datë 14.10.2021, është përgjigjur se: “*rezulton i padënuar nga gjykata penale Shqiptare.*”

71. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile me shkresën nr. 4460/1 prot., datë 16.08.2021, është përgjigjur se: “*Nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.*”

72. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka dërguar përgjigje, me shkresën nr. 15819/3 prot., datë 28.10.2021, sipas të cilës rezulton se:

“Albert Isuf Demirneli, lindur më 28.07.1964, nuk figuron i ndaluar/arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit.

- Nuk ka gjeneralitete të tjera të regjistruara, përveç atyre të përmendura më sipër.

- Nuk rezulton të jetë dëbuar nga territori i ndonjë shteti tjetër.

- Pas verifikimit të kryer në arkivin elektronik ZOK Interpol Tirana dhe sistemin ASF-2, të Interpolit, ka rezultuar se për këtë shtetas nuk ka të dhëna.

73. Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallë së Parë, pranë Gjykatës së Apeleve dhe SPAK kanë kthyer përgjigje pranë KED, sic citohet në pikat 38, 39 dhe 41 dhe nga përmbajtja e tyre konfirmohet fakti se ndaj kandidatit Albert Demirneli nuk rezulton të jetë regjistruar procedim penal.

74. Nga përmbajtja e informacioneve dhe akteve të dërguara në përgjigje të kërkesave të Këshillit si dhe pretendimet dhe dokumentacioni i paraqitur nga kandidati Albert Demireli, siç parashtrohet në pikat 38, 39, 40, 41, 42 dhe 43 më sipër, Këshilli konstaton se:

75. Me vendimin e datës 04.08.2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është vendosur mosfillimi i procedimit penal, të regjistruar më datë 24.07.2020 mbi bazë të materialit kallëzues të sjellë me anë të shkresës nr. 353/3, datë 20.07.2020 nga ana e Sektorit të Koordinimit Institucional, Sektori i Koordinimit të Studimeve pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Me anë të kësaj shkrese është përcjellë kallëzimi i shtetasit A.H., kryer ndaj kandidatit Albert Demireli për veprën penale të “Shpërdorimit të Detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, si Prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjithashtu, rezulton se me vendimin nr. 05.11.2020 të jetë vendosur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës mosfillimi i procedimit penal të kallëzimit nr. 4116, regjistruar më datë 30.10.2020 të këtij shtetasi (A. H.) të kryer ndaj kandidatit Albert Demireli. Në lidhje me kallëzimin e shtetasit M.R. (materiali hetimor nr. 1044/2019) të kryer ndaj kandidatit Albert Demireli rezulton të jetë marrë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës vendimi i mosfillimit të procedimit penal me datë 18.04.2019. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka dërguar vendimet gjyqësore përkatëse në lidhje me këta shtetas: vendimi nr.(11 -2019-3240) 344, datë 11.06.2019 me kërkuar Metush Rama; vendimi nr.(11-2020-3571) 541, datë 28.12.2020, me ankues Altin Hoxha.

76. Në lidhje me kallëzimin e shtetasës L.Xh. nga dokumentacioni i administruar pranë KED rezulton se shtetësja L.Xh. midis pretendimeve të ngritura prej saj për një mosmarrëveshje pronësie me persona të tjerë dhe pretendime për vendime të padrejta të organeve gjyqësore në dëm të saj, ka përmendur edhe faktin se në vitin 2006, nga ana e kandidatit Albert Demireli është marrë vendim për mosfillimin e procedimit penal, vendim i cili sipas saj është i padrejtë. Nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të jetë regjistruar procedimi penal nr. 27, viti 2019, pa emër të regjistruar, mbi bazën e akteve të procedimit penal nr. 159, datë 15.07.2019, të dërguara për kompetencë nga ish Prokuroria për Krime të Rënda, Tiranë.

77. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në lidhje me kallëzimin e shtetasës L.Xh. ndaj disa shtetasve, prokurorëve dhe gjyqtarëve, midis të cilëve prokurorit Albert Demireli në lidhje me vendimin e mosfillimit të procedimit penal të datës 06.11.2006, ka arritur në përfundimin se *“Nga hetimet e kryera në lidhje me këtë procedim, nuk rezulton që të ketë elemente të veprës penale të “korrupsionit pasiv të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç, i K.Penal.”* Në këto kushte, më datë 31.03.2021, ka vendosur shpalljen e moskompetencës dhe kalimin e akteve për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

78. Këshilli konstaton se rrethanat e mësipërme në lidhje me kallëzimet e kryera ndaj kandidatit Albert Demireli të kenë qënë objekt hetimi i thelluar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Vendimi nr. 323, datë 10.12.2020 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për konfirmimin në detyrën e prokurorit të kandidatit Albert Demireli ka marrë formë të prerë më datë 10.02.2021, si vendim i paankimuar.

79. Rezulton nga dokumentacioni i depozituar nga kandidati Albert Demireli, së bashku me spjegimet e tij të datës 12.11.2021, se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor më datë 03.09.2021 i ka paraqitur kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pushimin e procedimit penal nr. 2474, viti 2021, për veprën penale të “falsifikimit të dokumenteve”

lidhur me pretendimet e shtetases L.Xh. Në përmbajtje të kërkesës së prokurorit të datës 03.09.2021 thuhet ndër të tjera se: *"... nga aktet e administruara figuron që kemi të bëjmë me një konflikt civil, i cili pasqyrohet edhe në vendimet e mësipërme të gjykatave. Gjatë hetimit në asnjë moment nuk ka të dhëna apo dyshime për veprime korruptive pasi kallëzuesja ka hedhur dyshime vetëm në lidhje me proceset gjyqësore që nuk kanë qenë në favor të saj si dhe për privatizimin në vitin 1991. Edhe pretendimet për korrupsion të ngritura prej saj në lidhje me punonjësit e administratës që janë marrë me hartimin e dokumentacionit të privatizimit në vitin 1991, nuk qëndrojnë pasi nuk ekziston asnjë fakt i kundërligjshëm i mbështetur në prova, indicie apo dyshime. Nisur nga sa më sipër si dhe nga shqyrtimi në tërësi i akteve dhe provave të administruara në kuadrin e këtij procedimi penal, rezultojnë se çështja penale duhet pushuar, pasi fakti nuk përmban elementë të veprës penale të "Falsifikimit të dokumenteve", i parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal apo të ndonjë veprë tjetër penale. Gjithashtu, vihet re se për pretendimet që ka ngritur kallëzuesi lidhur me veprimet e punonjësve të administratës së asaj kohe që kanë marrë pjesë në privatizimin e furrës së pjekjes, këto veprime, edhe nëse prezumojmë se kanë ndodhur kanë kaluar më shumë se 29 vjet, nga kryerja e pretenduar dhe në të tilla rrethana, vepra penale e dyshuar është parashikuar..."* Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e datës 05.11.2021.

80. Në vijim të procedurave të verifikimit të integritetit, kandidati Albert Demireli ka dorëzuar të plotësuar, në afat, formularin e aplikimit "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", parashikuar nga ligji nr. 45/2015. KED me shkresën nr. 78 prot., datë 29.07.2021 i dërgoi për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit formularin përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati Albert Demireli. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 1143/10 prot., datë 22.09.2021, ka dërguar vendimin nr. 396, datë 09.09.2021 pranë KED me rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Albert Demireli, duke ardhur në përfundimet se: *"Për zotin Alket Bashkim Jaupi, nga verifikimet e kryera deri tani nuk figurojnë të ketë materiale në dokumentet të ish- Sigurimit të Shtetit në emër të tyre, sipas nenit 29, pika 2 të ligjit nr. 45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".*

81. Këshilli, bazuar në të dhënat dhe aktet e mësipërme të administruara në dosjen e kandidimit lidhur me procesin e verifikimit të integritetit dhe pas shqyrtimit të informacionit të dërguar nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, arrin në përfundimin se nga kontrolli i kryer nuk rezultojnë që kandidati Albert Demireli të gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

82. Neni 7/a pika 1 shkronja "d" i ligjit nr. 8577/2000 si kusht kandidimi përcakton që kandidati *"të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi."* Nga dokumentacioni i shqyrtuar në dosjen e kandidimit dhe përgjigjet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë, siç tregohen në pikën 45 më sipër, Këshilli konstaton se kandidati Albert Demireli nuk rezultojnë të jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore. Po kështu, nuk rezultojnë që kandidati të ketë masa disiplinore në fuqi. Për rrjedhojë, kandidati Albert Demireli nuk gjendet në kushtet e ndalimit sipas kësaj dispozite.

vi. Verifikimi i pasurisë

83. Përsa i përket procedurës së verifikimit të pasurisë, në përfundim të veprimeve të kontrollit të ushtruar, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr. 9367/2005, ILDKPKI me shkresën nr. 3211/1 prot., dhe nr. 3211/2 prot., datë 03.09.2021, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Aktin Përfundimtar nr. 557/23, datë 03.09.2021 dhe rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Albert Demireli dhe personat e lidhur me të. Ky kontroll rezultoi të jetë ushtruar për periudhën nga data 31.01.2017 e në vijim, pasur parasysh vlerësimin e pasurisë për këtë kandidat të kryer në zbatim të ligjit nr. 84/2016, për të cilin KED ka administruar vendimin nr. 323, datë 10.12.2020 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

84. Në përfundim të analizës financiare, të kryer mbi bazën e gjetjeve të siguruar nga informacionet e dërguara nga institucione publike dhe subjekte private, lidhur me deklarimin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Albert Demireli, ILDKPKI në raportin e paraqitur konkludon se:

- a) *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.*
- b) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë.*
- c) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
- ç) *Nuk ka kryer deklarim të rremë.*
- d) *Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

85. KED verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara nga kandidati Albert Demireli në deklaratën e depozituar pranë ILDKPKI, mbi bazën e të cilave ky institucion ka realizuar analizën financiare, në raport me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e dërguara pranë tij nga institucioneve publike dhe subjekteve private të treguara në pikën 49 më sipër. Nga përgjigjet e administruara rezultoi se nuk ka informacione shtesë për pasuritë dhe interesat private dhe ato përputhen me ato të ILDKPKI-së. Gjithashtu, Këshilli vlerësoi se nga ana e ILDKPKI është e zaturuar në mënyrë shteruese verifikimi i pasurisë së kandidatit Albert Demireli dhe ka rezultuar pa probleme.

86. Për këto arsye, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Albert Demireli ka *“kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij”*. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016 ky kandidat nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit edhe përsa i përket verifikimit të pasurisë.

87. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacioni që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatit Albert Demireli, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 22.11.2018, 19.04.2019 dhe rishpallur në datë 03.06.2021.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 229, pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236, pikës 3 të nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, si edhe të shkronjës *“a”* të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve*

për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”,
Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të kandidatit Albert Demireli, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 22.11.2018, 19.04.2019 dhe rishpallur në datë 03.06.2021.
2. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Albert Demireli.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.


ANËTARE
Elsa TOSKA

Zv/KRYETARE
Kundër
Marsida XHAFERLLARI


KRYETAR
Ervin PUPË


ANËTAR
Adnan XHOLI


ANËTAR
Astrit KALAJA


ANËTARE
Kundër
Elona TORO


ANËTAR
Gjon FUSHA


ANËTAR
Kleanthi ZEKA


ANËTARE
Rilinda SELIMI

MENDIM PAKICE

Në cilësinë e anëtarëve Marsida Xhaferllari (zëvendëskryetare) dhe Elona Toro kemi votuar kundër vendimit nr. **19, datë 26.11.2021** të KED-së për lejimin e kandidimit të z. Albert Demirneli për vendin vakant të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 22.11.2018, 19.04.2019 dhe 03.06.2021.

Në vlerësimin tonë, kandidati Albert Demirneli duhej ndaluar të kandidonte me arsyetimin se nuk përmbush kushtin e përcaktuar në shkronjën "d" të pikës 3 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatës Kushtetuese - "Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese (shtuar me ligjin nr.99/2016, neni 6) në të cilën parashikohet se :

"1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;*
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.*

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriteret:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;*
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;*
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.*

3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:

- a) vjetërsisë në profesion;*
- b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë;*
- c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;*
- ç) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;*

d) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimin përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;

dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

4. *Organet e emërtesës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjinore.”.;*

Nga interpretimi i dispozitave kushtetuese (neni 124) rezulton se Gjykata Kushtetuese konsiderohet si autoriteti më i lartë që i shërben si garant i respektimit të epërsisë së Kushtetutës në raport me normat e tjera të së drejtës duke penguar çdo veprim arbitrar të mbartëseve të funksioneve të pushtetit publik. Në këtë kontekst, *lex speciales* Ligji Nr.8577, datë 10.2.2000 (ndryshuar me ligjin nr.99/2016) “Për Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” si edhe **Ligji nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”** ka përçuar qëllimin e kushtetutëbërësit për të garantuar një përbërje cilësore, *par excellence*, të individëve të përzgjedhur përcaktuar kjo në kriteret objektive të qarta dhe të matshme për formimin arsimor të lartë, profesional si edhe integritetit dhe figurës. Përmes vendosjes së kushteve dhe kriterëve ligjore të emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese synohet përzgjedhje e kandidatave nga disa fusha, të cilat janë të domosdoshëm për autoritetin që realizon drejtësinë kushtetuese pasi disponimi nga ana e tyre të niveleve me të larta të njohurive tekniko-juridike në fushën e gjyqimit kushtetues, do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e vendimmarrjes.

Pikërisht këtë ka synuar të sanksionojë edhe gërma “d” e Ligjit organik të organizimit dhe funksionimit të Gjykatës Kushtetuese. Gërma “d” e pikës 3 të nenit 7/a të tij ka përcaktuar si limit minimal të përzgjedhjes së kandidatit, të gjithë ata individë që kanë një vlerësim të përgjithshëm mesatar në formimin e lartë juridik jo më pak se 8.

Përcaktimi i këtij pragu minimal në formë, të qartë edhe të shprehur, *expressis verbis*, nga ligji nuk lejon mundësi përzgjedhjeje tej kriterit objektiv, notë mesatare 8 në arsimin të lartë juridik duke siguruar në këtë mënyrë transparencë, të qartë e gjithëpërfshirëse mbi bazën e meritokracisë e njohurive në fushën juridike.

Nga aktet e administruara gjatë procedurës së verifikimit rezulton se Gjykata e Lartë, në datën 22.11.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të përfundimit të mandatit, si pasojë e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit Fatmir Hoxha. Hapja e procedurës është shpallur në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/ç të Ligjit nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim ligji nr. 8577/2000). KED, me vendimin nr. 6, datë 05.04.2019, ndër të tjera, ka

vendosi pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave për këtë vakancë të shpallur, si dhe njoftimin e Gjykatës së Lartë për të vlerësuar rishpallje e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave në datën 03.06.2021, Gjykata e Lartë, ka rishpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e këtij vendi vakant. Pas përfundimit të afatit, kjo Gjykatë i ka dërguar KED-së, një listë të dytë të kandidatëve, ku përfshihej edhe kandidatura e z. Albert Demirneli.

Nga procedura e verifikimit ka rezultuar se në lidhje me plotësimin e kritereve formale të parashikuara nga neni 7/a i ligjit nr. 8577/2000 , dhe konkretisht "*arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8*", kandidati Albert Demirneli ka përfunduar studimet në vitet 1983-1987 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike Juridik, diplomuar "Jurist", pajisur me Diplomë nr. 1756 B, datë 27.06.1987, por me notë mesatare 7.3.

Kushtet e kandidimit për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese të parashikuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe akteve ligjore të nxjerra në zbatim të saj të cituara edhe më lart, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku në mënyrë që kandidati të pranohet për tu vlerësuar dhe renditur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi për vendet vakant në Gjykatën Kushtetuese.

Në kushtet kur kandidati nuk plotëson një nga kriteret e përcaktuara nga neni 7/a i ligjit të sipërcituar ai nuk mund të vijojë kandidimin për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese.

Zëvendëskryetare

Marsida Xhaferllari

Anëtare

Elona Tori